



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo
Finansija, Rada i Trasfera –
Ministry of Finance, Labour and Transfers



AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
AGENCIJA ZA ZAPOSŁJAVANJE REPUBLIKE KOSOVO
EMPLOYMENT AGENCY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Në bazë të Rregullores MF-nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OJQ-ve, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK), përgjigjet në pyetjet e pranuar për “Thirrje Publike për Ofrimin e Mbështetjes Financiare për Organizatat Jo-Qeveritare që Ofrojnë Trajnime për Aftësi të Buta për deri 300 Punëkërkues (mosha 18 – 24 vjeç) në 7 Qendrat Kryesore të Kosovës”

1. Tek dokumentet e nevojshme për aplikim kërkohet “Lista e ATK-së”, çfarë liste specifikisht është kjo?

Përgjigje: Lista e kërkuar nga ATK është lista që dëshmon të punësuarit në organizatën tuaj.

2. A mundemi që trajnimet ti mbajmë në më pak se 7 qendrat kryesore të Kosovës?

Përgjigje: Jo. Siq është e specifikuar në thirrje, trajnimet nga OJQ përfituese duhet të mbahen në të 7 qendrat e Kosovës.

3. A mundet që vlera e projektit të jetë me e madhe se sa vlera e thirrjes?

Përgjigje: Jo. Vlera e thirrjes është e caktuar në shpalljen për thirrje publike, dhe vlera e saj nuk mund të ndryshohet.